

UDHËZIM
Nr. 6, datë 2.4.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 9.1.2019, “PËR ZHVILLIMIN E
PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, VITI SHKOLLOR 2018-2019”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012 datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 9.1.2019, “Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018-2019”, shkronja “a” e pikës 1, ndryshon si më poshtë:

“a. Lënda gjuhë e huaj, më 13 qershor 2019.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini